

VENDIM
Nr. 83, datë 6.4.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “VOSKOPOJË”, ME FUQI
TOTALE TË INSTALUAR
1970 kw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”; 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”, me fuqi totale të instaluar 1970 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 182 prot., datë 15.2.2018, shoqëria “Favina 1” sh.p.k. ka paraqitur në ERE një kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”, me fuqi totale të instaluar 1970 kw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 49 datë 7.3.2018, vendosi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”, me fuqi totale të instaluar 1970 kw.

- Në vijim të këtij vendimi, ERE, në zbatim të nenit 19, pika 2, të “Rregullave organizimit dhe procedurave të ERE-s” dhe të nenit 10, pika 8 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, në datat 9 dhe 10.3.2018, publikoi në median e shkruar njoftimin lidhur me aplikimin e bërë nga ky subjekt.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”.

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003, ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 69, datë 21.12.2007, ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 79, datë 23.10.2009, ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 153, datë 12.11.2012, shoqëria “*Balkan Green Energy*” sh.p.k. është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga 25 HEC-e vendore (ekzistues), ndër të cilat dhe HEC “Voskopojë”, me fuqi të instaluar 400 kw.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 930, datë 2.10.2009, nga lista e 25 HEC-eve vendore në licencën e shoqërisë “*Balkan Green Energy*” sh.p.k., janë hequr HEC-et “Piqeras”, “Lozhan” dhe “Voskopojë”.

- Në vijim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 930, datë 2.10.2009, ERE është shprehur me vendimin nr. 161, datë 6.10.2016, “Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “*Balkan Green Energy*” sh.p.k., me nr. 3, seria PV03K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 69, datë 12.12.2007”.

- HEC “Voskopojë” rezulton në pronësi të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., vërtetuar nëpërmjet aktit të shitblerjes nr. 4952 prot., nr. 4040 kol., datë 27.12.2015, me certifikatë pronësie (dublikatë), nr. 1062411, datë 23.6.2015, lëshuar nga ZRPP Korçë.

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin

e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Favina 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”, me fuqi të instaluar 1970 kw, për një afat 30-vjeçar (tridhjetëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti